Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
01 No.Nr. 018-22
Tarih/Dt. 28.09.2022

Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin nenit 17, shkronja (j) dhe shkronjën (m), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 40, të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2013", e konform nenit 43, lidhur me nenin 44 dhe 45, të Statutit të Komunës së Mamushës, i datës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës në Mamushë në mbledhjen e mbajtur me datë, ~~28.07.22~~, miratoi këtë:

01-Nr- 018-22

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim themelohet **"Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare" në Komunën e Mamushës (në tekstin e mëtejmë QKMF), me statusin e person Juridik.**

Neni 2

"Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare", selinë do ta ketë në rrugën **"Asker"** në Mamushë.

Neni 3

"Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare", themelohet për ushtrimin e veprimtarisë të Kujdesit Parësor Shëndetësor, ashtu si që është e përcaktuar me Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2013" dhe aktet nënligjore të nxjerrura nga Ministria e Shëndetësisë si dhe me Statutin e QKMF-së.

Neni 4

"Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare", do ti ketë këto organe; **1.** Drejtorin, **2.** Këshillin Drejtues, **3.** Këshillin Profesional dhe **4.** Organet tjera sipas nevojës së institucionit, fushëveprimi dhe kompetencat e këtyre organeve përcaktohen me Statut të QKMF-së dhe me aktet tjera nënligjore të nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 5

Me Statutin e QKMF-së, me Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e brendshëm dhe me aktet tjera të përgjithshme të nxjerra nga Këshilli Drejtues e të miratuara nga themeluesi, do të përcaktohet; Udhëheqja, mbikëqyrja, organizimi, funksionimi, autorizimet, mjetet të cilat i nevojiten institucionit për fillimin e punës, mënyrën e sigurimit të tyre, mënyra e fitimit dhe menaxhimit të mjeteve, mënyra e vendosjes së organeve, si dhe rregullohen çështjet tjera me rëndësi për ushtrimin e veprimtarisë së **"Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare"**.

Neni 6

Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës, veprimtarisë dhe akteve të përgjithshme, si dhe zbatueshmërin e tyre e bënë themeluesi, në bashkëpunim me autoritetet e përcaktuar nga Ministrin e Shëndetësisë.

Neni 7

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Mamushë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Neemedin MORINA